


AVOKAT: FATON FETAHU
Rr. "Rexhep Luci", 1/2, kati II, nr. 4, Prishtinë



Datë: 30 maj 2025

PËR: **ZYRËN E RREGULLATORIT TË ENERGJISË**, ME ADRESË: RR. BEKIM FEHMIU (ISH NDËRTESTA E FAZITËS), KATI: 2, 10000 PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS

NGA: **PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS**, ME ADRESË: RR. NËNA TEREZË NR. 20, PRISHTINË, E PËRFAQËSUAR NGA KRYETARI I SAJ, Z. MEMLI KRASNIQI, TË CILËN NË BAZË TË AUTORIZIMIT E PËRFAQËSON I AUTORIZUARI I SAJ¹

LËNDA: **KUNDËRSHTIM ADMINISTRATIV KUNDËR AKTIT REAL - NJOFTIMIT PUBLIK MBI LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË NË KOSOVË**

Në mbështetje të par. 2 të nenit 14, nenit 124, par. 3, nënpar. 3.2, nenit 136, par. 1, nënpar. 1.1 dhe nenit 137, par. 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*Gazeta Zyrtare nr. 20, 21 qershor 2016*), Partia Demokratike e Kosovës (në tekstin në vijim, referuar me shkurtesën initiale PDK dhe/ose parashtruesi i këtij Kundërshtimi Administrativ), palë e autorizuar në këtë procedurë, brenda afatit të paraparë ligjor, parashtron këtë mjet të rregullt juridik, për ndërprerjen e zbatimit të aktit real të kundërshtuar, nga ana e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Ekektrike (në tekstin në vijim referuar me shkurtesën initiale: ZRRE), – Njoftimit Publik mbi Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë, (në tekstin në vijim referuar: Akti real i kundërshtuar/kontestuar) i publikuar më datë 12 mars 2025.

➤ **PËRMBLEDHJA E FAKTEVE:**

1. Më datë 12 mars 2025, ZRRE në faqen e saj elektronike ka publikuar aktin real me titullin "Njoftim Publik mbi Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë", përmes të cilit ka përcaktuar detyrimin e KESCO si furnizues i shërbimit universal që të identifikoj konsumatorët familjarë dhe ata jofamiljarë, të cilët e gëzojnë të drejtën e shërbimit universal, ndërsa në të njëjtin njoftim, po ashtu, ka përcaktuar se konsumatorët që nuk plotësojnë kriteret në shërbim universal, do të dalin në treg të lirë, duke filluar nga data 1 qershor 2025.
2. Në të njëjtin njoftim, gjithashtu, janë obliguar konsumatorët jofamiljarë që të paraqesin pranë KESCO dëshmitë nëse përmbushin kriteret e furnizimit me shërbim universal.

¹ Bashkëngjitur këtij kundërshtimi gjeni autorizimin përkatës;

3. Nga dita e publikimit të këtij akti real, e deri në ditën e parashtrimit të këtij kundërshtimi, ZRRE, fare nuk ka marrë në konsideratë reagimet, mospajtimet dhe vërejtjet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile, organet profesionale, duke përfshirë edhe odat respektive ekonomike, se zbatimi i procesit të liberalizimit të tregut do të ketë pasoja të pariparueshme të interesave të rreth 1300 biznesve, të mbi 140 mijë punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve, e për rrjedhojë, akti real i kontestuar do të prodhojë pasoja të drejtëpërdrejta në zhvillimet makroekonomike të vendit, duke përfshirë mundësinë reale për falimentimin e ndërmarrjeve, nxitjen e inflacionit të menjëhershëm dhe si pasojë e tij edhe rritjen e çmimeve të produkteve në nivel të përgjithshëm.

Provë: <https://www.gazetaexpress.com/oda-ekonomike-amerikane-ne-kosove-liberalizimi-i-tregut-te-energji-se-kercenon-bizneset-dhe-vendet-e-punes/>

<https://paparaci.com/507829/oek-kerkon-ta-pezullohet-vendimi-per-daljen-e-bizneseve-ne-tregun-e-lire-te-energji-se-nga-1-qershor/>

Kërkesa publike e OEK, e datës 08.05.2025 për pezullimin e vendimit për daljen në tregun e lirë të bizneseve nga data 1 qershor 2025:

4. Nga sa u theksua më sipër, mbi veprimet procedurale dhe faktet e përmbledhura, në vijim shtrojmë bazën ligjore të arsytimit të këtij kundërshtimi dhe të argumentojmë domosdoshmërinë për ndërprerjen e zbatimit të aktit real të kundërshtuar dhe efekteve të tij.

➤ **OBJEKTI I ÇËSHTJES SË KONTESTUAR – AKTI REAL I KUNDËRSHTUAR :**

5. Çështja e parë që konsiderojmë që është e rëndësishme për t'a sqaruar përballë ZRRE është baza ligjore për ushtrimin e këtij mjeti juridik të njohur si Kundërshtimi Administrativ.
6. Ligji i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret është Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare nr. 20, 21 qershor 2016), i cili shprehimisht në pjesën e VII "Mjetet Juridike Administrative", në Kapitullin I "Dispozitat e Përgjithshme dhe Mjetet Juridike Administrative, Neni 124 "Legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative", taksativisht, përcakton që:

"1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim "...";

2. Përveç nëse caktohet ndryshe me ligj, mjetet juridike administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë;

3. Mjetet juridike administrative, të rregullta, janë: 3.1. ankesa; 3.2. kundërshtimi administrativ;"

Contact: +383 44 981 529; fetahufaton@gmail.com

7. Ky ligj, në nenin 136 "Objekti i kundërshtimit administrativ", përcakton se objekt i kundërshtimit janë aktet reale dhe në kuptim të nenit 69 të LPPA, akti real përbën çdo veprim të organit publik në fushëveprimin e së drejtës administrative, që nuk është akt administrativ apo kontratë administrative, dhe që mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi (siç janë: informacionet publike, deklaratat, mbajtja e evidencave, lëshimi i certifikatave, veprimet e ekzekutimit dhe veprimet e tjera faktike).
8. Në këtë kuptim, PDK, në mbështetje të ligjit në fuqi për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit në fuqi për Financimin e Partive Politike është subjekt juridik jo fitimprurës, mbrojtëse e interesave kolektive dhe interesave të gjera të publikut, paraqitet si palë në këtë procedurë, në kuptim të nenit 14, par. 2 të LPPA, për arsye se konsideron se në rrethanat e rastit konkret, me aktin real të kontestuar cenohen substancialisht interesat juridike dhe legjitime të publikut dhe një komuniteti të gjerë kolektiv, cenimi i të cilave, në thelb, përbën cenim të interesit shtetëror dhe publik të Republikës së Kosovës.
9. Andaj, në kuptim të nenit 136, par. I, nënpar. I.I, PDK kërkon ndërprerjen e zbatimit të aktit real të kontestuar dhe përmes tij edhe eliminimin e pasojave që i njëjti i shkakton.
10. Përveç si më sipër, duke marrë për bazë faktin se akti real i kontestuar ndërlidhet ekskluzivisht me përmbushjen e shërbimeve publike të interesit të përgjithshëm në kuptim të nenit 70 të LPPA, PDK kërkon nga ZRRE (i cili në këtë rast vepron si organ me kompetenca rregullatore, mbikëqyrës dhe licencuese) që të zbatoj përgjegjësitë e saj ligjore në bazë të ligjit në fuqi për ZRRE, ligjit në fuqi për Energjinë Elektrike dhe dispozitat e këtij neni të LPPA, sipas të cilave, në rastin konkret ZRRE duhet të sigurojë vazhdimësinë, njëtrajtshmërinë, përballueshmërinë dhe cilësinë e përshtatshme të shërbimit, transparencën e procedurave dhe mosdiskriminimin e përfituesve të këtij shërbimi – energjisë elektrike – edhe për konsumatorët të cilët në bazë të nenit 37, par. 2 të Ligjit në fuqi për Energjinë Elektrike, nuk kualifikohen si përfitues të shërbimit universal.

➤ **PASOJAT E PARIPARUESHME NGA ZBATIMI I EFEKTIT JURIDIK TË AKTIT REAL TË KONTESTUAR;**

11. PDK, me qëllim të argumentimit të faktit se akti real i kontestuar krijon pasoja të pariparueshme të karakterit publik, i refereohet edhe opinionit të Institucionit të Avokatit të Popullit, nr. KPD/745/25, i datës 29 maj 2025, në rastin nr. 538/25, "në lidhje me rritjen e çmimit të energjisë elektrike nga Zyra e Rregullatorit për Energji", sipas të cilit, përveç tjerash është trajtuar edhe çështja e largimit të konsumatorëve nga e drejta e furnizimit si shërbim universal, të cilët kanë qarkullim vjetor më shumë se 10 milion euro, ose kanë më shumë se 50 punonjës, respektivisht është trajtuar objekti i aktit real të kontestuar.

Provë: Opinioni i Institucionit të Avokatit të Popullit, nr. KPD/745/25, i datës 29 maj 2025, në rastin nr. 538/25;

12. Ashtu siç argumenton edhe parashtruesi i këtij kundërshtimi, se akti real i kontestuar shkakton pasoja të pariparueshme ndaj interesit publik, ashtu edhe opinioni i lartcekur i IAP në përfundimet e tij (pika 45), në mënyrë të qartë ka konstatuar se "Qeveria e Republikës së Kosovës është dashur që në konsultim me ZRRE të gjej një zgjidhje të përshtatshme tek rasti i nxjerrjes së konsumatorëve nga e drejta e furnizimit si shërbim universal, të cilët kanë qarkullim vjetor më shumë (10) dhjetë milion euro, ose më shumë se pesëdhjetë (50) punëonjës, sepse kjo situatë ka rrezik të shkaktojë një inflacion të ri, i cili mund të rezultojë me situatë të papërbalueshme për ekonominë familjare për qytetarët e Republikës së Kosovës, e po ashtu mund të rrezikoj ekzistencën e ndonjë subjekti afarist, si dhe krijon mjedis jo të favorshëm për zhvillimin e aktiviteteve biznesore në Republikën e Kosovës".

13. Përveç si më sipër, parashtruesi i këtij kundërshtimi, kërkesën e tij për ndërprerjen e zbatimit të aktit real të kontestuar, zbatimi i të cilit pritet të filloj më datë 1 qershor 2025, e mbështet edhe në Analizën mbi Ndikimin e Liberalizimit të Tregut të Energjisë të nxjerrë nga ana e Odës Ekonomike të Kosovës dhe të publikuar në muajin maj 2025.

Provë: Analiza mbi Ndikimin e Liberalizimit të Tregut të Energjisë të nxjerrë nga ana e Odës Ekonomike të Kosovës dhe të publikuar në muajin maj 2025;

14. Sipas kësaj analize, është bërë edhe vlerësimi i numrit të bizneseve të prekura nga akti real i kontestuar, i cili vlerësim, duke ju referuar të dhënave të siguruara nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) për vitin 2024, ka gjetur se: "Nga gjithsej 1,252 subjekte ekonomike që përmbushin njërin nga kriteret e përcaktuara nga ZRRE, 934 prej tyre (përkatesisht 74.6%) i plotësojnë kriteret në bazë të numrit të të punësuarve, pra kanë më shumë se 50 punëtorë. Ndërsa, 318 subjekte ekonomike (25.4%) i përmbushin kriteret në bazë të qarkullimit vjetor, duke gjeneruar mbi 10 milionë euro në vit. Nga këto, 218 subjekte ekonomike përmbushin njëkohësisht të dy kriteret, si në aspektin e numrit të të punësuarve ashtu edhe në atë të qarkullimit financiar.". Rrjedhimisht, lehtësisht mund të konstatohet se akti real i kontestuar do të shkaktoj pasoja të mëdha dhe të pariparueshme si në drejtim të strukturës së veprimtarive ekonomike, ashtu edhe në aspektin e cenimit marrëdhënies së punës të rreth 140 mijë punonjësve të ndërmarrjeve të prekura dhe kësijoj do të rezultojn me pasoja ekonomike dhe financiare jo vetëm të familjeve dhe bizneseve të prekura, por edhe të ekonomisë së vendit në përgjithësi.

15. Për më tepër, parashtruesi i këtij kundërshtimi, argumentet mbi pasojat e pariparueshme të aktit real të kontestuar i mbështet, po ashtu, edhe në vetë Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (miratuar më 18 janar 2017 nga Bordi i ZRRE), sipas nenit 2 (parakushtet për liberalizim të tregut) të të cilit parashihet se Liberalizimi i tregut të energjisë do të bëhet në mënyrë graduale, duke i shfrytëzuar të gjitha mundësitë që sektori i energjisë në Kosovë të përshtatet me ligjet e reja në fuqi. Pikërisht sipas këtij neni, në rrethanat e rastit konkret, ZRRE nuk i ka përfillur as parakushtet të cilat vetë i kishte përcaktuar në aktin e që e kishte miratuar.

16. Gjithashtu, sipas nenit 3 të të njëjtit Udhëzues është përcaktuar shprehimisht detyrimi që ZRRE, në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe me Zyrën e Ndihmës Shtetërore, të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe një raport të tillë hetimor t'a publikoj. Përkundër këtij detyrimi, ZRRE deri në ditën e nxjerrjes së aktit real të kontestuar nuk ka hartuar, miratuar dhe publikuar një raport të tillë hetimor, i cili mbi të gjitha sipas par. 2 të nenit 3 të Udhëzuesit, në radhë të parë duhet të vlerësojë dhe konstatojë nëse ka apo jo konkurrencë efektive të tregut të energjisë, në mënyrë që të ndër marrë hapa për zbatimin e par. 2 të nenit 37 të Ligjit për Energji Elektrike.
17. Argumentin se ZRRE ka dështuar që të përmbush parakushtet për liberalizim të tregut, të përcaktuar si në nenin 2 të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (miratuar më 18 janar 2017 nga Bordi i ZRRE), argumentohet edhe me faktin se pikërisht neni 8, par. 1, nënpar. 1.3 i këtij Udhëzuesi (i cili i'u referohet konsumatorëve komercial – të cilët me aktin real të kontestuar nga data 1 qershor 2025 do të dalin jashtë furnizimit nga shërbimi universal) është ndryshuar dhe plotësuar 3 herë me radhë, me tre udhëzime të njëpasnjëshme nga vetë ZRRE, duke u nisur pikërisht nga fakti se si pasojë e mospërmbushjes së parakushteve konsumatorët e kësaj kategorie do të vazhdojnë të trajtohen në mënyrë të barabartë përmes shërbimit universal, pa e rrezikuar ekzistencën e tyre si rezultat i mungesës së konkurrencës efektive. Ky fakt mbështetet në këto prova:
1. *Udhëzuesi për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë – 13 qershor 2018;*
 2. *Udhëzuesi i datës 30 tetor 2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar me datë 13 qershor 2018;*
 3. *Udhëzuesi i datës 28 mars 2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar me datë 13 qershor 2018 dhe i ndryshuar dhe plotësuar më datë 30 tetor 2018;*
18. Rrjedhimisht, mungesa e një raporti hetimor mbi konkurrencën efektive të tregut të energjisë, në të cilën do të kishte rol vendimtar Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (këtu e tutje: AKK) dhe Zyra e Ndihmës Shtetërore, aktin real të kontestuar e nxjerrë në shpërputhje të plotë me vetë detyrimin e lartcekur të ZRRE, e cila në mënyrë të kundërligjshme ka vlerësuar përmbushjen e kushteve të konkurrencës efektive për kalimin e konsumatorëve në treg të hapur, ndonëse një vlerësim të tillë ka kompetencë ekskluzive kushtetuese dhe ligjore që ta ofroj vetëm Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.
19. Ky argument gjen mbështetje në nenin 26 (Përgjegjësitë e Komisionit) të ligjit në fuqi për Mbrotjtjen e Konkurrencës, sipas të cilit, ky institucion jep mendime profesionale dhe rekomandime sipas nenit 32, ku sipas këtij të fundit, këto mendime ose rekomandime janë në përgjegjësi ekskluzive të këtij autoriteti dhe të cilat me vetë - iniciativë apo me kërkesë

të organeve publike (në këtë rast me kërkesë të ZRRE), ofron mendime profesionale, përveç tjerash edhe për projekt-aktet nënligjore që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën e tregut, sikurse është rasti konkret me hyrjen në fuqi të aktit të kontestuar.


20. Ndërkaq, ZRRE, me aktin real të kontestuar askund nuk i referohet mendimit profesional apo rekomandimit të AKK mbi përmbushjen e kushteve të konkurrencës efektive të tregut, por arbitrarisht në pasuesin e dytë të par. 4 të njoftimit – aktit real të kontestuar, ka konstatuar si vijon: *"Megjithatë, tani janë plotësuar kushtet e nevojshme për t'u mundësuar konsumatorëve që përmbushin kriteret të kalojnë në treg të hapur dhe të përfitojnë nga mundësitë e konkurrencës"*.
21. ZRRE, duke i vlerësuar në mënyrë arbitrare dhe pa asnjë kompetencë ligjore kushtet e konkurrencës së tregut të lirë, ndërkohë më datë 18 prill 2025, pas aktit real të kontestuar, kishte publikuar edhe listën e ndërmarrjeve të licencuara për furnizim me energji elektrike, të cilat sipas ZRRE mund të kryerjnë aktivitetin e furnizimit me shumicë (tregtisë) së energjisë elektrike në Kosovë.

Provë: Lista e publikuar më datë 18 prill 2025, e ndërmarrjeve të licencuara;

22. Duke ju referuar listës së lartcekur të ndërmarrjeve të licencuara për furnizim me energji elektrike për konsumatorët të cilët përmbushin kushtet për të dalur në treg të hapur më 1 qershor 2025, konstatohet se më shumë se 90% e tyre nuk janë ndërmarrje prodhuese të energjisë elektrike, por janë të licencuara për tregti të energjisë elektrike, e rrjedhimisht KESCO ka pozitë dominuese në treg, për faktin se sipas analizës së OEK, vetëm kjo e fundit ka hapur mundësinë e ofertimit për furnizim me energji elektrike në raport me ndërmarrjet e interesuara, me çmime prej 220% deri 280% më të larta.
23. Andaj, bazuar në provat dhe argumentet e lartcekura, parashtruesi i këtij kundërshtimi konsideron se akti real i kontestuar është nxjerrë si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, baza të cilat e bëjnë të detyrueshëm ndërprerjen e zbatimit të efektit juridik të aktit të kontestuar, zbatimi i të cilit pritët të filloj më 1 qershor 2025.

PROPOZIM -VENDIM

- I. **APROVOHET** si i bazuar kundërshtimi administrativ i Partisë Demokratike të Kosovës;
- II. **NDËRPRITET** zbatimi i aktit real - Njoftimit Publik mbi Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë të Zyrës së Rregullatorit për Energji;

Me nderime,
Av. Faton Fetahu

AVOKAT - LAWYER
FATON FETAHU
Tel. 044/981-529
Email: fetahufaton@gmail.com

Contact: +383 44 981 529; fetahufaton@gmail.com